

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6555
E enjte, 10 mars 2022
çmimi 0.40 €

Zelensky:
Zona e ndalimfluturimit
do ta parandalonte katastrofën
humanitare | FAQE 2



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

ANËTARËSIMI I KOSOVËS NË NATO VLERËSOHET ÇËSHTJE URGJENTE | FAQE 4-5

KOSOVA THEMELON GRUPIN PUNUES PËR ANËTARËSIM NË NATO



Qeveria e Kosovës ka marrë vendim të mërkurën për formimin e grupit ndërinstitucional për anëtarësimin e Kosovës në NATO. Objektivi kryesor i këtij grupi do të jetë avancimi i procesit të integritimit në NATO, fuqizimi i pranisë së Kosovës në organizata dhe mekanizma rajonale dhe ndërkombëtarë të sigurisë, si dhe bashkëpunimi me aleatët strategjikë ndërkombëtarë. Partitë e opozitës i kanë dhënë mbështetje qeverisë për rrugëtimin e anëtarësimin të Kosovës në NATO

OPINION

NGA BURGUNË LIRI,
21 VJET MË PARË | F.9

Sadik
ZEQIRI



AKTUALE



RAMA PARALAJMËRON RITJE
MARRAMENDËSE TË ENERGJISË
ELEKTRIKE | F.3

NDËRRON JETË ISH-KRYETARI I
ISTOGUT, HAKI RUGOVA | F.7

QYTETARËT NUK KANË
NEVOJË TË KRIJOJNË REZERVA
TË BARNAVE | F.7

EKONOMI



QEVERIA NDAN 50 MILIONË
EURO PËR SUBVENCIONE
NË BUJQËSI | F.8

15 vjet përpjekje
për aprovimin e
Ligjit për Qeverinë
| FAQE 3



RRITEN ÇMIMET NË KOSOVË,
KURTI THOTË SE KJO NUK ËSHTË
SHKAKTUAR NGA QEVERIA E TIJ
| FAQE 4-5

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

HAJDARI PARALAJMËRON
KONTROLL TË TREGUT
TË NAFTËS NË KOSOVË | F.8

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Scholz: Nuk do të dërgojmë avionë luftarakë në Ukrainë

BERLIN, 9 MARS - Gjermania nuk do të dërgojë avionë luftarakë në Ukrainë, tha kancelari gjerman Olaf Scholz. Ky koment erdhi pasi Shtetet e Bashkuara ka refuzuar ofertën e Polonisë që t'i transferojë avionët e saj të prodhimit rus, MiG-29, në bazën amerikane në Gjermani. "Ne kemi ofruar të gjitha llojet e

materialeve të mbrojtjes... kemi dërguar armë, gjë për të cilën iu kemi treguar, por po ashtu është e vërtetë që ne e kemi shqyrtuar me kujdes se çfarë do të bëjmë, dhe definitivisht avionët luftarakë nuk janë pjesë e kësaj", ka thënë Scholz gjatë një konference për medie mbajtur të mërkurën, së bashku me

kryeministrin kanadez Justin Trudeau.

Scholz, po ashtu, u pyet nëse Gjermania e refuzon në mënyrë kategorike ndalesën e importeve të energjisë ruse dhe tha se për disa muaj është duke punuar që shteti i tij ta ulë varësinë nga importet e karburanteve.



Zelensky: Zona e ndalimfluturimit do ta parandalonte katastrofën humanitare

KIEV, 9 MARS - Presidenti ukrainas Volodymyr Zelenskiy ka thënë se nëse nuk shpallet zona e ndalim-fluturimit për ta mbrojtur Ukrainën, komuniteti ndërkombëtar do të jetë përgjegjës për katastrofë të madhe humanitare.

Zelenskiy ka thënë të mërkurën se Rusia ka rritur shkallën e sulmeve në ditën e 14-të të luftës dhe se bota nuk mund të rrijë duarkryq. "Rusia përdor raketa, aeroplanë dhe helikopterë kundër nesh, kundër civilëve, kundër qyteteve tona, kundër infrastrukturës tonë. Është detyrë humanitare e botës që të përgjigjet", ka thënë ai.

NATO-ja ka hedhur poshtë mundësinë e zbatimit të ndalim-fluturimit për shkak të shqetësimeve të përballjes së drejtpërdrejtë me Rusinë.

Zelensky u ka bërë thirrje fuqive të Perëndimit që menjëherë ta zgjidhin ofertën polake, e cila do t'i mundësonte shtetit të tij të furnizohej me aeroplanë luftarakë rusë MiG-29 - një lloj i aeroplanit luftarak që pilotët ukrainas dinë si ta përdorin.

Më 8 mars Uashingtoni ka hedhur poshtë idenë e Polonisë për t'ia dorëzuar ShBA-së aeroplanët rusë në bazën ajrore amerikane në Gjermani.

Uashingtoni ka thënë se një veprim i tillë mund ta përshkallëzojë konfliktin.

"Kur do të merret vendimi? Dëgjoni: Ne jemi në luftë! Ne nuk kemi kohë për këto shenja. Ky nuk është pingpong. Këto janë jetë njerëzish. Ne po bëjmë thirrje sërish: Zgjidheni shpejt. Mos u largoni nga përgjegjësia, na dërgoni aeroplanët", ka thënë Zelensky. I pyetur si e



sheh Moskë ofertën polake, zëdhënësi i Kremlinit, Dmitry Peskov, ka thënë se kjo do të krijonte "një skenar potencialisht të rrezikshëm dhe të padëshirueshëm".

Ukraina kërkon armëpushim pas ndërprerjes së rrymës në Çernobil

Ministri i Jashtëm ukrainas, Dmytro Kuleba, i ka bërë thirrje Rusisë që të pajtohet për armëpushim, në mënyrë që të kryhen riparime në centralin bërthamor të Çernobilit, vendi

ku ka ndodhur katastrofa më e madhe bërthamore.

Ky central është shkëputur plotësisht nga rrjeti elektrik dhe ka shqetësime për rrjedhje të rrezatimit.

Kompania ukrainase e Energjisë, Ukrenergo, ka thënë më 9 mars se rryma është ndalur në central për shkak të një ndërprerjeje të linjës elektrike që lidh centralin bërthamor të Çernobilit me furnizuesin e energjisë elektrike në Kiev.

Kjo ndërprerje rrezikon rreth 20 tonë mbetje që duhet të ftohen vazhdimisht për t'i parandaluar rrjedhjet që potencialisht mund ta rrezikojnë "Ukrainën,

Bjellorusinë, Rusinë dhe Evropën". "E gjithë linja e furnizimit në centralin bërthamor të Çernobilit dhe objektet bërthamore, të kontrolluara nga ushtria ruse, janë dëmtuar", ka thënë Kuleba në "Twitter". "Çernobili është pa rrymë. I bëj thirrje gjithë komunitetit ndërkombëtar që t'i kërkojnë Rusisë armëpushim të menjëhershëm dhe t'i mundësojnë riparimet sa më shpejt që është e mundur", duke theksuar se gjeneratorët kanë kapacitet të ftohjes për 48 orë, më pas sistemet mund t'i bëjnë rrjedhjet e rrezatimit "të pashmangshme".



BE-ja do t'i zgjerojë sanksionet ndaj zyrtarëve dhe oligarkëve rusë

BRUKSEL, 9 MARS - Bashkimi Evropian është pajtuar për ta zgjeruar raundin e tretë të sanksioneve që i janë vendosur Rusisë për të shënjestruar një numër më të madh të oligarkëve dhe zyrtarëve të afërt me presidentin rus, Vladimir Putin, për shkak të sulmit të paprovokuar të Moskës ndaj Ukrainës.

Presidenca franceze e Këshillit Evropian ka thënë më 9 mars se sanksionet e reja do të zbatohen ndaj "liderëve rusë dhe

oligarkëve, si dhe familjeve të tyre", duke përmendur se ata janë përfshirë në agresionin rus kundër Ukrainës.

Raundi i tretë i sanksioneve ndaj Rusisë, njëherësh pakoja më e madhe e bllokut evropian me sanksione prej nisjes së pushtimit rus më 24 shkurt, përfshin ngrirje të aseteve të Bankës Qendrore të Rusisë në BE, si dhe ndalesë ndaj medieve të Kremlinit në bllok.

Sipas Presidencës franceze, sanksionet synojnë t'i

përfshijnë edhe tri banka bjelloruse nga sistemi financiar i pagesave, SWIFT, ta sqarojnë çështjen e kriptovalutave dhe të ofrojnë një listë të mallrave që nuk mund të shiten mes Rusisë dhe BE-së. Bashkimi Evropian ka sanksionuar deri më tani 680 njerëz dhe 53 subjekte prej kur Rusia ka aneksuar Krimenë më 2014, më pas kur ka njohur pavarësinë e rajoneve Donjeck dhe Luhansk në lindje të Ukrainës, dhe pas nisjes së sulmit rus në Ukrainë.



Rama paralajmëron rritje marramendëse të energjisë elektrike

TIRANË, 9 MARS (ER) - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka folur sërish për situatën me energji elektrike. Ai ka thënë se Shqipëria nuk e prodhon ende dot të gjithë sasinë e energjisë që i nevojitet. "Prodhimi ynë varet nga reshjet e shiut e të borës, të cilat për vitin e tretë rresht janë shumë më të ulëta sesa deri tri vjet më parë. Thatësira çon deri në pikën që thuajse gjysma e nevojave për energji të mbulohet nga importi, ndërkohë që prej disa muajsh bota ka hyrë në një krizë energjetike. Tanimë edhe për shkak të luftës në Ukrainë, çmimi për megavat vazhdon të rritet çmendurisht, orë e çast,



nga 52 euro vjet, në 550 euro aktualisht!", ka shkruar Rama në llogarinë e vet në "Facebook".

Rama ka theksuar se gjasat janë që rritja marramendëse të vazhdojë dhe parashikimet shkojnë deri në çmendurinë

totale të 1 000 eurove për megavat orë. "Qysh me shfaqjen e shenjave të krizës energjetike disa muaj më parë,

qeveria ka paralajmëruar kohë të vështira përpara dhe ka vendosur një mburojë financiare për familjet dhe biznesin e vogël. Sot Shqipëria është ndoshta i vetmi vend që nuk e ka rritur asnjë qindarkë faturën e energjisë; aktualisht çmimi i importit për kilovat ka shkuar 61 lek, ndërkohë që familjarët vijnë ta paguajnë kilovatin njësoj si përherë, 9.5 lek. Të gjithë këtë diferencë të frikshme ekonomikisht e mbulon krejtësisht shteti, përtej 45 milionë USD që shkojnë çdo vit nga buxheti i shtetit për kompensimin e 2.5 lekëve për kilovat për çdo familje në nevojë", ka thënë Rama.

15 vjet përpjekje për aprovimin e Ligjit për Qeverinë

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 9 MARS - Instituti GAP ka publikuar raportin "15 vjet përpjekje për aprovimin e Ligjit për Qeverinë". Që nga viti 2008 Projektligji për Qeverinë është miratuar tri herë në qeveri dhe dy herë është shqyrtuar nga Kuvendi i Kosovës, por asnjëherë nuk është shndërruar në ligj.

Përpjekjet e qeverive të ndryshme për aprovimin e një ligji të veçantë për qeverinë kanë të bëjnë me formulimin në nenin 92.2 të Kushtetutës së Kosovës që thotë se "Qeveria e Kosovës ushtron pushtetin ekzekutiv në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin", si dhe me presionin e vazhdueshëm të shoqërisë civile për ta kufizuar numrin e ministrave.

Në këtë raport Instituti GAP ka paraqitur edhe një historik të shkurtër të përpjekjeve për aprovimin e Ligjit për qeverinë, përmbajtjen e projektligjeve të deritanishme, si dhe dilemat ligjore në përcaktimin e numrit të posteve ministore me ligj. Projektligji për qeverinë, i cili u aprovua në fund të vitit 2021 dhe u dërgua në Kuvend, në masë të madhe është përsëritës i Rregullores për përgjegjësitë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrave, si dhe i Kushtetutës së Kosovës. Risia e vetme që është përfshirë



në draftin aktual të Projektligjit është inkorporimi i obligimeve që dalin nga Ligji për Barazi Gjinore, dhe përfaqësimi i barabartë i grave dhe burrave në postet ministore. Në qeverinë aktuale gratë udhëheqin me 33 për qind të ministrave si dhe mbajnë 23 për qind të posteve të zëvendësministre.

Në këtë raport Instituti GAP ka dhënë disa rekomandime sa i përket shqyrtimit të Projektligjit në Kuvend.

Mes të tjerash, GAP rekomandon që të shtohen edhe pika të tjera të cilat obligojnë qeverinë që para se të themelojë një ministri të re, të hartojë një memorandum shpjegues për arsyet dhe përfitimet që mund t'i sjellë shoqërisë themelimi i një ministrie të re; të bëjë një vlerësim të ndikimit financiar, duke përfshirë në mënyrë të detajuar numrin e zëvendësministre, këshilltarëve politikë dhe stafit tjetër të kabinetit sikurse numri i shërbyesve civilë, kostot e pagave dhe shpenzimet e tjera; ta shpjegojë hapësirën e punës ku do të operojë dhe relacionin me ministrinë e tjera. Përveç kësaj, para vendimit përfundimtar, qeveria të mbajë dëgjime publike me shoqërinë civile, si dhe t'i paraqesë argumentet zyrtarisht para komisionit parlamentar funksional që do ta mbikëqyrë punën e ministrisë së re.

Dy të vdekur dhe 49 raste të reja me Covid në Kosovë

PRISHTINË, 9 MARS (ER) - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se gjatë 24 orëve të fundit, prej 1 268 testeve, 49 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19. Gjatë 24 orëve të fundit janë shënuar dy raste të vdekjes. Të mërkurën janë shënuar 80

qytetarë, derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve është 222 776.

Në total numri i rasteve aktive me Covid është 831.

Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se në 24 orët e fundit janë dhënë 257 doza të vaksinës kundër Covid-19. Prej

fillimit të vaksinimit në të gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 1 816 525 doza të vaksinës.

Deri më sot 817 708 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë.

Deri më sot janë dhënë 98 354 doza përforcuese dhe doza të treta të vaksinës kundër Covid-19.





ANËTARËSIMI I KOSOVËS NË NATO, VLERËSOHET ÇËSHTJE URGJENTE

Kosova themelon grupin punues për anëtarësim në NATO

Qeveria e Kosovës ka marrë vendim të mërkurën për formimin e grupit ndërinstitucional për anëtarësimin e Kosovës në NATO. Objektivi kryesor i këtij grupi do të jetë avancimi i procesit të integritimit në NATO, fuqizimi i pranisë së Kosovës në organizata dhe mekanizma rajonale dhe ndërkombëtarë të sigurisë, si dhe bashkëpunimi me aleatët strategjikë ndërkombëtarë. Partitë e opozitës i kanë dhënë mbështetje qeverisë për rrugëtimin e anëtarësimit të Kosovës në NATO

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 9 MARS - Qeveria e Kosovës ka marrë vendim të mërkurën për formimin e grupit ndërinstitucional për integritimin e Republikës së Kosovës në NATO. Ky grup synon ta shtojë punën dhe t'i bashkërendojë veprimet për realizimin e aspiratës shtetërore të Republikës së Kosovës për integritime euroatlantike; ta përforcojë bashkëpunimin me partnerët ndërkombëtarë dhe ta avancojë praninë e Kosovës në mekanizmat e tjerë rajonale dhe

ndërkombëtarë të sigurisë dhe mbrojtjes.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se objektivi kryesor i këtij grupi do të jetë avancimi i procesit të integritimit në NATO. Ministrja për Punë të Jashtme dhe e Diasporës, Donika Gërvalla, ka thënë se anëtarësimi i Kosovës në NATO është çështje urgjente, duke përmendur pushtimin rus në Ukrainë. "Kosova dhe shtetet e tjera demokratike pro-perëndimore në rajon po ballafaqohen çdo ditë e më shumë me veprime destabilizuese, të provokuara nga Rusia përmes vartësve të saj.

Duke marrë parasysh kontekstin aktual të agresionit të paprecedentë rus ndaj Ukrainës, dhe synimeve për destabilizim dhe minim të të gjitha progreseve euroatlantike e kërcënimit për paqen globale, anëtarësimi i Kosovës në NATO është urgjent si rrallëherë më parë për solidifikimin e arkitekturës së sigurisë në rajon dhe Evropë", ka thënë Gërvalla.

Ministrja e Jashtme do të jetë kryesuese e këtij grupi, kurse anëtarë do të jenë ministri i Mbrojtjes, ministri i Punëve të Brendshme dhe ministrja e Drejtësisë.

Përfaqësues do të ketë nga Presidenca, Kryeministria, përfaqësuesi i Kosovës për marrëdhënie me NATO-n, nga Ambasada e Kosovës në Bruksel dhe ambasadori i Kosovës në Shtetet e Bashkuara. Prej nisjes së luftës në Ukrainë autoritetet e Kosovës kanë bërë thirrje për anëtarësimin e Kosovës në aleancën veriatlantike.

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë më 5 mars se anëtarësimi i Kosovës në NATO është i domosdoshëm që të ruhet

paqja në rajon. "Anëtarësimi në NATO mbetet objektiv strategjik i shtetit tonë, andaj anëtarësimi është më i domosdoshëm se kurrë, dhe është parakusht për paqen në rajon", ka deklaruar Osmani.

Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, ka thënë se anëtarësimi i Kosovës në NATO ishte dhe mbetet prioriteti kryesor strategjik i Republikës së Kosovës. "Në momentumin e ri gjeopolitik, kam besimin e plotë se aleatët tanë vendimmarrës në krye më ShBA-në do ta përshpejtojnë procesin e anëtarësimit tonë", ka thënë Mehaj.

Opozita mbështet qeverinë për anëtarësimin e Kosovës në NATO

Nënkryetarja e Partisë Demokratike të Kosovës, Vlora Çitaku, ka thënë të mërkurën se Qeveria e Kosovës duhet të angazhohet dhe të punojë për anëtarësimin e Republikës së Kosovës në Këshillin e Evropës. Çitaku ka theksuar se deri tani kjo

nuk ka qenë e mundur për shkak të ndikimit të Rosisë, por me krijimin e një situatë të re ku kjo fundit është suspenduar nga Këshilli i Evropës për shkak të agresionit ndaj Ukrainës, është momentumi që Qeveria e Kosovës ta nisë procedurën e anëtarësimit në këtë strukturë të rëndësishme. "Anëtarësimi i Kosovës në Këshillin e Evropës përbën një përfitim të shumëfishtë për vendin tonë në drejtim të fuqizimit të demokracisë, sundimit të ligjit dhe bashkëpunimit në familjen evropiane e më gjerë. Në mes të tjerash, është përfitim për qytetarët tanë, të cilëve do t'u mundësohej qasja në drejtësi në Gjykatën Evropiane të Drejtave të Njeriut në Strasburg, aty ku zbatohen parimet e drejtësisë së Kështillit të Evropës. Neni 3 i Statutit të Kështillit të Evropës obligon një shtet që ta respektojë parimin e sundimit të ligjit si dhe t'i respektojë të drejtat e njeriut, dy shtylla që ne si shtet i kemi të

Rriten çmimet në Kosovë, Kurti thotë se kjo nuk është shkaktuar nga qeveria e tij

PRISHTINË, 9 MARS (ER) - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se ngritja e çmimeve në gjithë botën e prodhimeve elementare është kostoja e mbrojtjes së lirisë së Ukrainës. Në mbledhjen e qeverisë të mërkurën ai ka thënë se Kosova preket nga ngritja e çmimeve për shkak të varësisë së saj të madhe nga importi. “Kujtojmë se Rusia është një prej eksportuesve më të mëdha të gazit dhe naftës në Evropë. Energjia që mundëson prodhimin dhe nafta për transport janë fillimi dhe fundi i zinxhirit. E di edhe kuptojmë shqetësimin e gjithsecilit prej

jush për rritjen e çmimeve. Edhe pse kjo s'është shkaktuar nga ne, po na prek edhe ne. Kur para 12 ditëve iu bashkuam botës për sanksionet, një kosto e tillë ishte e pashmangshme. Por kjo është kostoja e mbrojtjes së lirisë dhe demokracisë”, ka thënë Kurti. Një valë e re çmimesh nga tregjet e huaja pritet ta godasë edhe tregun e Kosovës për shkak të nisjes së pushtimit të Ukrainës nga Rusia, thonë ekspertë për çështje ekonomike.

Rritja e çmimit të derivateve dhe energjisë në botë pritet që drejtpërdrejt t'i rrisë edhe

çmimet e produkteve të tjera, pasi në Kosovë sasia më e madhe e mallrave importohen nga shtetet e Bashkimit Evropian dhe ato të rajonit.

Çmimet e derivateve tashmë janë rritur.

Në Kosovë, më 9 mars, një litër naftë është shitur për 1.68 euro dhe 1.72 euro, ndërsa benzina deri në 1.62 euro, varësisht nga operatori ekonomik dhe lokacioni. Kjo rritje ka shënuar nivelin më të lartë në 20 vjetët e fundit.

Madje këto ditë në dyqane janë vërejtur edhe ngritje të çmimeve të produkteve bazike. Një litër vaj shitet 2.29 euro,

pesë kilogramë miell 3.99 euro dhe një kilogram sheqer nga 0.79 në 0.95 euro.

Shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri, ka thënë se në gjendje të jashtëzakonshme nuk ka sjellje të zakonshme. Ai ka thënë se situata është e jashtëzakonshme, përderisa qeveria këtë gjendje po e trajton sikur të jetë e zakonshme.

Tahiri ka thënë i kanë propozuar Qeverisë së Kosovës pesë pika e që do të ndikojnë në lehtësimin e jetës së qytetarëve të Kosovës në këtë kohë. “Këto janë pesë propozimet emergjente të AAK-së: 1.

Kërkojmë që derisa të aprovohet ligji i pagave secilit zyrtar publik me vendim të qeverisë t'i ndahen nga 100 euro shtesë; 2. Largimin e akcizës, përkohësisht për derivate; 3. Kërkojmë që të ketë subvencionime shtesë nga Ministria e Bujqësisë për ata që sigurojnë grurin e miellin përmes riorganizimit të buxhetit të Ministrisë së Bujqësisë; 4. Të rritet paga minimale në Kosovë, vendim për pagën menjëherë; 5. Tashmë këtë e kemi në procedurë për Kushtetuese, tarifat e reja të energjisë, të ketë veprime urgjente”, thënë Tahiri.



konsoliduara tashmë si kriterë”, ka deklaruar Çitaku.

Ajo ka thënë se PDK-ja vlerëson se kjo është një çështje emergjente tani për tani dhe si parti lidere e opozitës, do ta mbështesë fuqishëm qeverinë në këtë objektiv shtetëror dhe në hapet e tjerë që duhet të ndërmarrë për anëtarësim në NATO dhe BE. “Reagimi emergjent ndaj kërcënimeve rreth sigurisë nuk mund të zëvendësojë në mënyrë afatgjatë atë për të cilën Kosova ka nevojë sot më shumë se kurrë, përkatësisht anëtarësimin në NATO dhe Bashkim Evropian. Për këtë arsye, duke parë zhvillimet politike që po ndodhin

kudo përreth nesh, ne i bëjmë thirrje qeverisë sonë që pa humbur kohë të angazhohet në rrafshin diplomatik për njohje nga pesë vendet anëtare të BE-së të cilat nuk e kanë njohur ende Kosovën”, ka theksuar Çitaku.

Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku, ka thënë se anëtarësimi i Kosovës në NATO është domosdoshmëri. “Bashkimi i tanishëm euroatlantik si reagim ndaj tiranisë ruse mbi Ukrainë është një dritare historike për Kosovën. Anëtarësimi ynë në NATO sot ka një mundësi të re. Kosova, institucionet tona, diplomacia jonë, duhet të shfrytëzojnë këtë dritare historike që rrallëherë na

hapet kaq shumë, e aleatët tanë ndërkombëtarë duhet ta përshpejtojnë anëtarësimin tonë si proces të natyreshëm të sigurisë evropiane. Kosova në NATO është domosdoshmëri. Gjithnjë ka qenë, gjithnjë do të jetë”, ka thënë lideri i LDK-së, Lumir Abdixhiku.

Edhe kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, para disa ditësh ka kërkuar nga kryeministri Albin Kurti që të ndërmarrë hapa zyrtarë për anëtarësimin e Kosovës në NATO. “Kryeministër Kurti, bëj kërkesë zyrtare për anëtarësimin e Kosovës në NATO. Mos u vono se situata është më serioze se sa mund të kujtos! Retorikat publike për anëtarësim

nuk janë të mjaftueshme. Vepra sipas procedurave e në formë institucionale”, ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në “Facebook”.

Para disa ditësh kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka thënë se është koha që në emër të sigurisë rajonale, kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, të marrë iniciativë për anëtarësimin e Kosovës dhe Bosnjës në NATO dhe t'i ftojë si bashkëinitiatorë edhe vendet e tjera të rajonit anëtare të NATO-s, të cilat kanë interes e shqetësim direkt për sigurinë e paqen në rajon, duke përfshirë Kroacinë, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Slloveninë. “Kjo iniciativë e

përbashkët t'i dorëzohet Asamblesë së NATO-s dhe ta fusin në rend të ditës në emër të sigurisë dhe paqes së kërcënuar në rajon. NATO duhet të miratojë në procedurë të veçantë pranimin e këtyre vendeve si anëtare të NATO-s”, ka thënë Limaj.

Traktati i NATO-s thotë se anëtarësimi në aleancë është i hapur për çdo shtet evropian që plotëson standardet e kërkuara, por aty theksohet se vendimi për zgjerim duhet të merret me marrëveshje unanime. Në radhët e NATO-s janë katër shtete që ende nuk e njohin pavarësinë e Kosovës: Greqia, Spanja, Rumania dhe Sllovakia.

Këndi arkivor i Shqipërisë në hapet komunën e Vushtrrisë

VUSHTRRI, 9 MARS (ER) - Në komunën e Vushtrrisë është përfunduar këndi arkivor i Shqipërisë për të siguruar qasje në dokumente për studiuesit, historianët dhe për të gjithë qytetarët që shprehin interesim. “Bashkë me zyrtarët dhe studiuesit e historisë pritëm në takim

drejtorin e përgjithshëm të Arkivave të Shqipërisë, Ardit Bido, zëvendësdrejtorin e përgjithshëm të Arkivave të Shqipërisë, Endrit Musaj dhe përgjegjës të Sallës së Studimit dhe bibliotekës, Myrteza Sharra”, ka bërë me dije drejtoresha e DKRS-së në Vushtri, Medina Bunjaku.

Ajo ka njoftuar se në këndin arkivor është i rregulluar sistemi efikas ku qytetarët e komunës së Vushtrrisë do ta kenë mundësinë e informimit dhe leximit digjital të literaturave, dokumenteve të vjetra dhe fotove të ndryshme me karakter historik.



Fillojnë punimet për ndërtimin e rrugëve në Mleqan

MALISHEVË, 9 MARS (ER) - Në kuadër të realizimit të projekteve dhe investimeve kapitale në komunën e Malishevës kanë filluar punimet për ndërtimin e dy rrugëve në fshatin Mleqan. Punimet në këto dy rrugë i kanë parë nga afër edhe i pari i Malishevës, Ekrem Kastrati dhe drejtori i Urbanizmit, Avdi Morina, të cilët gjatë vizitës në Mleqan janë takuar edhe me banorët. “Jam i kënaqur që kemi filluar punimet dhe realizimin e projekteve, pjesë e investimeve kapitale në komunën tonë, projekte të cilat do të vazhdojnë të realizohen sipas

planifikimeve të parapara për këtë vit. Ju banorë të Mleqanit i gëzofshi këto rrugë dhe këto investime që janë duke u realizuar në fshatin tuaj”, ka thënë Kastrati.

Drejtori i Urbanizmit, Avdi Morina, ka bërë me dije se në këtë fshat, krahas investimeve të tjera, kanë filluar punimet edhe për ndërtimin e dy rrugëve, me gjatë prej një kilometri, përkatësisht rrugët “Rizah Hajdini dhe “Hidajet Kryeziu”, ndërsa ndërtimi i këtyre rrugëve do të kushtojë mbi 62 mijë euro dhe mundësohet nga buxheti i komunës së Malishevës.



Komuna e Lipjanit falënderon Ambasadën Amerikane për përkrahje



LIPJAN, 9 MARS (ER) - Përfaqësues nga Ambasada Amerikane në Kosovë, të udhëhequr nga Ray Nayler, zëvendësdrejtor i sektorit për Marrëdhënie me Publikun, të mërkurën kanë vizituar komunën e Lipjanit, ku janë pritur nga Elmaze Behluli, drejtoreshë e Administratës Komunale dhe Anila Reqica, drejtoreshë për Kulturë, Rini

dhe Sport.

Temë diskutimi në këtë takim ishin sfidat dhe vështirësitë me të cilat ballafaqohen sektorët e ndryshëm të administratës komunale, me theks të veçantë fusha e arsimit, kulturës dhe rinisë me qëllim që të gjitha ato të integrohen në strategjitë e intervenimeve nga Ambasada Amerikane për përmirësimin e

jetës së të rinjve në komunën e Lipjanit.

Drejtoresha Elmaze Behluli ka falënderuar përfaqësuesit nga Ambasada Amerikane në Prishtinë për interesimin e tyre që të bashkëpunojnë me komunën e Lipjanit, në të njëjtën kohë janë zotuar që bashkërisht të punojnë për përmirësimin e jetës së të rinjve në Lipjan.

Komuna e Prizrenit premtion kushte më të mira për pensionistët

PRIZREN, 9 MARS (ER) - Nën kryetari i komunës së Prizrenit, Kujtim Gashi, ka takuar përfaqësuesit e Organizatës së Pensionistëve të Regionit të Prizrenit. Gashi ka thënë se në këtë takim theksuan nevojën e

domosdoshme për rifunksionalizimin e ambulancës së pensionistëve, barnat esenciale për ta, finalizimin e shtëpisë së pleqve, si dhe organizimet kulturore tradicionale për pensionistët.

“Bashkë me kryetarin e komunës, Shaqir Totaj, dhe ekzekutivin komunal, do të punojmë për adresimin dhe jetësimin e kërkesave për krijimin e kushteve më të mira për pensionistët”, ka thënë Gashi.



Drejtoresha Idrizi prezanton komunën e Mitrovicës në forume rajonale

MITROVICË, 9 MARS (ER) - Drejtoresha për Kulturë, Rini dhe Sport, Valdete Idrizi, ka marrë pjesë në “Forumit e Grave Shqiptare të

Suksesshme në Rajon”, i organizuar me datat 7 dhe 8 mars nga Unioni i Bashkive Shqiptare në Rajon dhe komuna e Preshevës. Qëllimi i

këtij organizimi ishte promovimi i modeleve frymëzuese dhe mbështetja e çdo zonje për ngritjen e kauzës për përfaqësim më të madh të

gruas në vendimmarrje dhe shoqëri. Ky forum është mbajtur në Preshevë, duke bërë bashkë kështu zonja të suksesshme nga i gjithë rajoni.



Qytetarët nuk kanë nevojë të krijojnë rezerva të barnave



PRISHTINË, 9 MARS - Kryetari i Odës së Farmacistëve të Kosovës, Arianit Jakupi, ka thënë se qytetarët e Kosovës nuk kanë nevojë të blejnë barna për të bërë rezerva në këtë situatë krize ekonomike e të sigurisë. Ai ka bërë me dije se ka mjaftueshëm barna në Kosovë, pasi është shtuar importi në javët e fundit, që të krijohen stoqe të volitshme, të cilat nuk do të ndikojnë as në

çmim. Jakupi ka thënë për "Klan Kosova" se nuk ka nevojë të blihen as barnat kundër ndonjë rrezatimi, pasi efektet e tyre nuk mbrojnë të gjitha pjesët e trupit, në rast të ndonjë sulmi të rëndë sigurie. Ai ka folur edhe për botimin më të ri të Regjistrimit të Barnave që u promovua më 7 mars. Sipas Jakupit, i njëjti botim, që ka rreth 750 faqe, ka përshkrim të detajuar për 817

lloje të barnave, sa janë tërësisht në Kosovë. "I njëjti regjistër do të shpërndalet falas nëpër të gjitha barnatoret e qendrat mjekësore, me të cilin më pas do të asistohen profesionistët shëndetësorë. Bashkë me Regjistrin e barnave është botuar edhe Revista Farmaceutike që ka të bëjë me sigurinë e produkteve mjekësore", ka thënë Jakupi.

Ndërron jetë ish-kryetari i Istogut, Haki Rugova

ISTOG, 9 MARS (ER) - Ish-kryetari i komunës së Istogut, Haki Rugova, është ndarë nga jeta të mërkurën në moshën 65-vjeçare.

Haki Rugova ka qenë kryeshef ekzekutiv i komunës së Istogut, nënkryetar i komunës dhe kryetar i komunës së Istogut për tri mandate që nga viti 2010 deri në vitin 2021 dhe anëtar i Bordit të Asociacionit të Komunave të Kosovës.

Kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku, i ka dërguar telegram ngushëllimi familjes Rugova. Ai ka theksuar se Haki Rugova ishte një personalitet dhe veprimtar i dalluar i LDK-së. "E nderuar familje Rugova, me dhimbje të thellë mora lajmin për ndarjen nga jeta të ish-nënkryetarit të LDK-së, ish-kryetarit të komunës së Istogut e të më të

dashurit tuaj, Haki Rugova. Haki Rugova ishte një personalitet dhe veprimtar i dalluar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, duke dhënë shembullin e përkushtimit dhe kontributit të jashtëzakonshëm në shtetndërtimin e Kosovës. Ai gjatë gjithë jetës u angazhua pandalshëm në proceset e vështira nëpër të cilat kaloi Kosova. Për më shumë se tri dekada qëndroi i palëkundur në veprimtarinë e tij atdhetare e politike dhe do të mbetet model i njeriut të urtë e punëtor, i afërt dhe bashkëpunues", është thënë në telegramin ngushëllues të Abdixhikut.

Edhe kryetari i komunës së Istogut, Ilir Ferati, ka ngushëlluar familjen Rugova. Ferati në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se Haki Rugova na la sot

për të mbetur në historinë moderne të Istogut e Kosovës si punëtor i madh, e një nga kontribuuesit më të mëdhenj në rrugëtimin tonë për liri, pavarësi e demokraci. "Me pikëllim të thellë mora lajmin për vdekjen e kryetarit Haki Rugova. Mik i familjes e bashkudhëtar për shumë kohë i babait tim, Haki Rugova, udhëhoqi komunën e Istogut dhe Lidhjen Demokratike të Kosovës në Istog për dhjetë vjet me radhë. Kryetari Rugova na la sot për të mbetur në historinë moderne të Istogut e Kosovës si punëtor i madh e një nga kontribuuesit më të mëdhenj në rrugëtimin tonë për liri, pavarësi e demokraci. Udhëtimi i tij politik në shërbim të vendit, i palëkundur nga vizioni i presidentit, është udhërrëfyes për gjeneratat e reja", ka thënë kryetari i Istogut, Ilir Ferati.



GAP-i: Projektet komunale ngecin deri në shtatë vjet



PRISHTINË, 9 MARS - Shpërfaqen dhjetëra mangësi dhe sfida që pushteti lokal ka në arritjen e standardeve të dëshiruara, në procesin e investimeve publike, shpenzimeve të buxhetit, alokimit të të hyrave vetjake dhe menaxhimit të pronave publike. Në këtë drejtim, një nga problemet më të mëdha, është pamundësia e komunave për t'i realizuar investimet brenda kohës së paraparë, ku ka projekte komunale që kanë ngecur për shtatë vjet. Bekim Salihu, analist i politikave në Institutin GAP, ka theksuar se nga 25 projekte të audituara për kohëzgjatjen e investimeve në 12 komuna, Zyra Kombëtare e Auditimit ka gjetur se ka projekte

që kanë nisur në vitin 2013 dhe të cilat nuk kanë përfunduar deri në fund të vitit 2020. "Ky problem ndikon keq në ecurinë e menaxhimit dhe shpenzimin e buxhetit. Shkaktarët të cilët e prodhojnë këtë gjendje, për disa arsye, janë mosplanifikimi i duhur i investimeve, mungesa e mjeteve të plota buxhetore, mungesa e mbikëqyrjes serioze dhe rigoroze nga komunat në terren dhe shpronësimi", ka thënë Salihu. Këto konkluzione dolën në tryezën gjatë prezantimit të të gjeturave nga raporti "Sfidat e komunave në menaxhimin e investimeve, shpenzimeve, të hyrave dhe pronave" të publikuar nga Institutin GAP.

IKShP-ja fillon sekuencionimin gjenetik

PRISHTINË, 9 MARS (ER) - Gjatë periudhës kohore 3 dhe 8 mars në Departamentin e Mikrobiologjisë në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës është kryer sekuencionimi gjenetik i shtatë mostrave pozitive në SARS-CoV-2 me Next Generation Sequencing (NGS) në aparatit MiSeq Illumina. Sekuencionimi është kryer nga një grup i personelit të IKShPK-

së me ndihmën e dy ekspertëve nga Robert Koch Institute në Berlin në kuadër të bashkëpunimit të vazhdueshëm.


Të gjitha mostrat e SARS-CoV-2 i takonin variantit Omicron, nënlinja BA-1.

Vendosja e kësaj metode të punës në IKShPK do ta përforcojë mbikëqyrjen virologjike të SARS-CoV-2 në Kosovë dhe të patogjenëve të

tjerë infektivë me rëndësi për shëndetin publik të Kosovës.

Personeli i IKShPK-së ka arritur që në vazhdimësi t'i risë kapacitetet e shërbimeve referente mikrobiologjike përkundër angazhimeve të përditshme në testimin e qindra-mijëra mostrave gjatë dy vjetëve të fundit të pandemisë me Covid-19.

IKShPK-ja ka njoftuar se vazhdon ta kompletojë dhe ta



përmirësojë kualitetin e shërbimeve në mbrojtje të

shëndetit të qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Hapet panairi i bizneseve të udhëhequra nga gratë

PRISHTINË, 9 MARS - EcoKos Women ka organizuar panairin për gratë e viseve rurale të Kosovës të angazhuara në aktivitete bujqësore dhe përpunim të ushqimit.

Në panair janë ekspozuar 12 agrobiznese të drejtuara nga gratë.

Blerim Hasani, sekretar i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ka thënë se kanë miratuar ligjin që u kanë dhënë bizneseve

prioritet. “Kemi rritje të shumave të subvencionimit. Zhvillimeve të agrobiznesit u kemi kushtuar rëndësi të veçantë. Do të përkushtohemi t'i përkrahim projektet e vogla të agrobiznesit. Ftojmë gratë të marrin pjesë në këto agrobiznese”, ka thënë ai.

Sandra Horina, shefe e Zyrës Koordinuese të Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim në Prishtinë, ka thënë se kanë mbështetur vazhdimisht

bizneset dhe gratë. “Ne i mbështesim ato për procedimin e ushqimeve në shtëpi dhe në aspektin e mjedrave. Ju mund t'i gjeni këtu gratë që janë pioniere në aspektin e bujqësisë. Mesazhi im është për to: se ato e kanë kthyer pasionin e tyre në biznes dhe produktet e tyre duhet të blihen. Jo vetëm që janë me cilësi të lartë, por edhe u ndihmon grave”, ka thënë Horina.



Hajdari paralajmëron kontroll të tregut të naftës në Kosovë

PRISHTINË, 9 MARS (ER) - Sasia e derivateve të naftës, që mund të blihet në tregun e Kosovës, është e kufizuar në disa të pika të shitjes, thonë pronarë të kompanive dhe anëtarë të Shoqatës së Naftëtarëve të Kosovës. Disa furnizues veçse kanë ndërprerë shitjen e derivateve për Kosovën. Kjo po ndodh në mesin e një krize të furnizimit me këtë produkt në Evropë, që ka ndikuar edhe në rritjen e çmimit të tij. Çmimet dhe kërkesa për naftë

janë rritur në tregjet ndërkombëtare pas ndërhyrjes ushtarake të Rusisë në Ukrainë. Nafta e papërpunuar Brent, e cila përdoret si pikë ndërkombëtare e referimit, më 8 mars shkoi në nën 130 dollarë për fuçi.

Në Kosovë, më 9 mars, një litër naftë është shitur për 1.68 euro, ndërsa benzina deri në 1.78 euro, varësisht nga operatori ekonomik dhe lokacioni.

Ministrja e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë,

Rozeta Hajdari, ka thënë të mërkurën se nuk ka bllokadë të furnizimit me naftë në tregun e Kosovës.

Hajdari në një konferencë për medie ka bërë me dije se së bashku me Autoritetin e Konkurrencës janë duke i identifikuar marrëveshjet e tregtarëve për manipulime të mundshme me produkte në treg. “Ne nuk mund t'i kontrollojmë çmimet, por mund të marrim masa. Ne kemi marrë masa të ndryshme, duke

filluar nga nafta. Mund të ketë edhe devijime të çmimit në treg, aty ku tregtohen dhe furnizohen. Kjo nuk është fer në treg dhe përmes bashkëpunimit me Autoritetin e Konkurrencës ne do t'i identifikojmë të gjitha këto marrëveshje të përbashkëta të tregtarëve dhe produkteve të ndryshme në treg”, ka thënë Hajdari.

Sipas saj, do të shtohen masat e kontrollit të vendimit të marzhës së naftës. “Jemi në

vëmendje të afërt me shtetet e rajonit, duke shikuar a kemi mundësi apo bllokadë që njoftohen apo keqnjoftohen. Pra, nuk kemi asnjë bllokadë për furnizim të naftës. Ndoshta javën e kaluar kishte ngadalësim nga Shqipëria, por me autoritetet jemi siguruar që nuk do të ketë vend për shqetësim të manipuluar se nuk ka stoqe në treg. Do t'i shtojmë masat e kontrollit të vendimit të marzhës së naftës”, deklaruar ministrja Hajdari.



Qeveria ndan 50 milionë euro për subvencione në bujqësi

PRISHTINË, 9 MARS (ER) - Ministri i Bujqësisë, Faton Peci, në një konferencë për medie, ka njoftuar të mërkurën se do t'i subvencionojnë bujqit dhe se për këtë kanë në dispozicion 50 milionë euro.

Ministri Peci ka thënë se për herë të parë bujqit do të subvencionohen edhe me naftë. “Ne nuk kemi qëndruar duarkryq karshi rritjeve të

çmimit të produkteve. Përkrahja do të jetë për drithëra, patate, fasule e të tjera. Kemi në dispozicion rreth 50 milionë euro. Do t'i subvencionojmë bujqit dhe fermerët”, ka thënë ai.

Ministri Peci ka thënë se nuk do të mbetet asnjë pëllëmbë e tokës pa u punuar. “Toka është pasuri, duart më të vlefshme janë ato që e punojnë tokën”, ka thënë ai.

Në konceptin e risive të Programit për Pagesa Direkte - Subvencione 2022, thuhet se “për herë të parë që nga paslufta fermerëve dhe bujqve tanë do t'u subvencionohet nafta në vlerë rreth 5 milionë euro, duke ia subvencionuar vlerën prej 0.36 centësh për çdo litër naftë të përlogaritur me hektarët e poseduar të tokës së punuar”.



Nga burgu në liri, 21 vjet më parë



Sadik ZEQIRI

21 vjet më parë, më 8 mars, isha i burgosur në burgun e Nishit. Disa ditë para kësaj date më kishte ardhur ftesa për gjykim. Ishte vendosur: gjykimi mbahej në gjykatën e Leksovcit. Mbahej aty sepse ne që ishim të akuzuar nga Prokuroria e Pejës, Gjykata e Qarkut e Pejës pas luftës kishte kaluar në Leskocv. Unë kisha marrë disa ftesa për gjykim, por ato shtyheshin pa arsye. Kisha bërë rreth dy vjet e gjysmë burg dhe ende mbaheja i pagjykuar. Në të njëjtën vepër me mua ishte edhe baca Ramë (i vrarë në Dubravë), por edhe Gëzimi dhe Arbeni. Të gjithë akuzoheshim për veprimtari armiqësore, sipas nenit 136, alineve 1 dhe 2, nenit 139, nenit 125 që përfshinte veprën për terrorizëm sipas kodit penal të Jugosllavisë që nuk ekzistonte më.

Ftesën e kishim marrë më 9 mars për paraqitje në Gjykatën e Leskocit. Seanca pritej të mbahej me fillim nga ora 9:30. Gardianët na njoftuan në mbrëmje që në orën 5.00 të mëngjesit të bëheshim gati për t'u nisur për në Leskocv. Atë ditë gjykoheshin edhe disa të burgosur të tjerë. Ne në burgun e Nishit bënim nganjëherë edhe kujdestari, pastronim gjithë natën korridorët e gjatë të pavijonit. Unë isha i burgosur në katin e tretë, në dhomën numër 13. Kati i tretë kishte shtatë dhoma me nga 50 të burgosur. Pasi të nesërmen, më 3 mars, kisha gjykimin, një nga shokët e dhomës, Agron Sylja, më zëvendësoi. Më tha shko bëj gjumë. Por gjithë natën nuk fjeta nga merak se çfarë do të ndodhte të nesërmen në seancë. Zbardhi mëngjesi i 3 marsit. Gardianët erdhën të grilat dhe thirrën emrin tim. Më kërkuan të çohem, të dal nga dhoma dhe të nisem për Leskocv. Unë veçse isha gati. Dolëm nga pavijoni, nga oborri i burgut dhe u nisëm për tek automjetet e burgut. Aty na i lidhën duart pas shpine dhe na futën në automjete. Nga Nishi për në Leskocv bëmë disa orë rrugë. Më në fund mbërritëm në oborrin e gjykatës. Në korridorët e Gjykatës së Qarkut të Leskocit pritëm disa orë sepse nuk kishte salla të lira për gjykim. Pas një pritjeje të gjatë filloi seanca ndaj ne të treve, që vazhdonin të na mbanin me duar lidhur. Gjykatësi na pyeti a e ndienim veten fajtorë dhe a ishim pjesë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Përgjigja jonë ishte: Nuk e ndiejmë veten fajtorë, ndërsa pranuan se ishim pjesëtarë të UÇK-së. Këtë udhëzim, për këtë deklaratë, e morëm nga shokët tanë më të vjetër që i kishim në burgun e Nishit. Pasi dëgjuan mendimin tonë dhe të prokurorëve, gjyqtarët na udhëzuan të dalim në korridor për ta pritur vendimin. Meqë ishte bërë një kohë e gjatë pas luftës, gjyqtarët kishin bërë ndryshime në aktakuzë. Në seancë na hoqën nenin 139 nga aktakuza. Me atë nen dënimi ishte mbi 10 vjet burg. Na kishte mbetur vetëm neni 136 në ndërlidhje me nenin 125.

Pas 30 minutash pauzë na ftuan të futemi në sallën e gjyqit për ta dëgjuar vendimin e gjykatësit dhe porotëve të tij. Fillimisht kërkuan të çohemi në këmbë. U çuam. Gjyqtari serb, në emër të popullit, shpalli aktgjykimin. U dënuam me nga 28 muaj burg, aq sa kishim mbajtur deri atë ditë. Mori vendim të na lirojë. Gardianët na i hoqën prangat. U gëzuam shumë. Dolëm nga salla e gjyqit dhe së bashku me gardianët u nisëm të dalim jashtë objektit të gjykatës. Kur dolëm në oborr ata nuk kishin vetura të na kthenin në Nish. Na thanë të flemë një natë në burgun e Leskocit. Kur na dërguan te burgu ata nuk na pranuan, me arsyetimin se tashmë ishim liruar nga gjykata. Mbetëm duke u sjellë nga burgu te gjykata. Pas dy orësh erdhi një veturë tjetër me disa të burgosur të burgut të Leskocit. Na futën në të e na sollën në Nish. Ora kishte shkuar tre pasdite. Në oborrin e burgut të Nishit shokët ishin ende aty. Na urdhëruan që para orës 16.00 të bëheshim gati dhe ta lëshonim burgun. I bëmë gati ato pak rroba që i kishim dhe dolëm në oborr. Aty na pritnin mbi 600 të burgosur shqiptarë për t'u përshëndetur me ne. Filluam të ndaheshim me shokët që kishim kaluar kohë të gjatë në këtë burg. Disa na jepnin nga një letër për t'ua dërguar familjarëve në Kosovë, disa na porositnin t'i vizitonim familjet e tyre. Derdhnin lot të gjithë, edhe ne me ta. Lotët tanë nuk ishin lot gëzimi, por lot mërzie që ne po dilnim e ata po i linim aty. Na hapën dyert e burgut dhe dolëm në rrugë. Ishim të lirë, por nuk dinim kah të shkonim. Nuk dinim as nga është Kosova, as nga cila anë është qyteti i Nishit. Rreth orës 17.00, pas një ore qëndrim në rrugë, erdhi drejtori i burgut të Nishit, e ndali veturën pra nesh dhe na pyeti pse po qëndrojmë aty. I thamë që s'ka ardhur askush të na marrë e të na dërgojë në Kosovë. Ai e njoftoi Kryqin e Kuq në Nish. Pas një kohe erdhën dy vajza. Na thanë të shkojmë në qytet, në zyrat e Kryqit të Kuq, për të fjetur aty




Sadik Zeqiri pas daljes nga burgu më 2001

deri nesër, sepse Kryqi i Kuq ishte njoftuar se ne do të lëshohemi nesër dhe se, po ashtu, nesër i sjellin edhe disa të burgosur nga burgu i Sremit të cilët ishin liruar dhe që të gjithëve na dërgojnë në Kosovë. Kjo ishte arsyeja që s'kishin ardhur të na pritnin. Ne insistuam të niseshim për Kosovë, jo për Nish. Më të sigurt e ndienim veten në burg sesa në Nish. Vajzat e Kryqit të Kuq e thirrën prapë drejtorin e burgut, e lutën të na linte të flinim deri nesër, por drejtori u tha. "Ne e respektojmë vendimin e gjykatës. Ata tashmë janë të lirë dhe nuk guxojmë t'i lejojmë brenda", u kishte thënë drejtori. I bindëm, me shumë këmbëngulësi, të na nisnin për Kosovë. Vajzat gjatë rrugës folën me Kryqin e Kuq Ndërkombëtar, me mision në Kosovë, me një djalë të nacionalitetit francez. Sebastiani e kishte emrin. Sebastiani na kishte vizituar disa herë në Nish. E njihnim dhe i besonim. Rreth orës 10.00 të natës arritëm në Merdar, në kufirin e Kosovës. Policia serbe e ndali veturën në të cilën ishim dhe na zbriti në tokë. Na kërkoi dokumentet e udhëtimit. Ne, përpos vendimit për lirim nga burgu, nuk kishim ndonjë

dokument tjetër. Na i mori të gjitha dokumentet, edhe letrat që na kishin dhënë të burgosurit për t'ua dërguar familjarëve të tyre. Pas shumë presioneve që na bënë milicët, na thanë të nisemi këmbë për ta kaluar kufirin. Në territorin e Kosovës na dolën përpara disa ushtarë dhe një përkthyes. Ne mendonim se ende jemi në territorin e Serbisë e se ata përballë nesh janë ushtarë serbë. Ata na ndaluan në një distancë prej 20 metrash sepse nuk e dinin kush jemi dhe nga vinim. Në gjuhën shqipe u thamë që jemi ish të-burgosur dhe që jemi liruar nga burgu. Vajza, përkthyes shqiptare, ka vrapuar në drejtimin tonë dhe na ka përqaftuar nga gëzimi dhe na ka uruar mirëseardhje në shtëpinë tonë, në shtetin tonë - Kosovë.

Më pas kemi hyrë në barakat e KFOR-it në kufi dhe aty na kanë shërbyer kafë espresso. Nuk kishim pirë kafë që me rastin e arrestimit. Ishte bërë kohë e gjatë. Pas një ore qëndrim aty ka ardhur Kryqi i Kuq në krye me Sebastianin. Kryqi i Kuq e kishte kontaktuar edhe vëllanë tim, Nekiun. Edhe ai ishte nisur bashkë me babanë tim për në Merdar. Derisa hipnim në veturat e Kryqit të Kuq, kanë

ardhur babai dhe vëllai im. Jemi përshëndetur me Sebastianin dhe kemi hyrë në veturën e familjes sonë. Jemi nisur për Gjakovë. Në shtëpi kemi mbërritur rreth orës tre të mëngjesit. U vonuam pak kohë pasi që së pari Gëzimin dhe Arbenin i dërguam në shtëpinë e tyre, më pas shkuam në shtëpinë time, ku më pritnin nëna dhe familjarët e tjerë. Mëngjesin e pritëm zgjuar, duke u çmallur me njëri-tjetrin. Lajmi për lirim tonë kishte marrë dhenë. Filluan të vijmë për vizitë qytetarë nga të gjitha viset e Kosovës. Vinin të njohur dhe të panjohur të cilët kishin familjarë të vet në burgje për të marrë ndonjë informacion për ta. Vizitat kanë zgjatur për ditë të tëra. Edhe pse ndodhesha në liri, gëzimin nuk e kisha të plotë. Më kishin mbetur në burgje shokët e ngushtë. Shokët e mirë. Përjetuesit e masakrës së burgut të Dubravës. Kisha përjetuar shumë vuajtje e tortura me ta në kohë të ndryshme, qysh në burgun e Pejës, të Dubravës, të Lipjanit, të Nishit e të Leskocit. Për koincidençë, 9 marsi i lirim tim përkoi me ditëlindjen e gruas sime, të Naimes, datë që s'e harroj kurrë dhe që e festojmë bashkë.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

Malisheva ia ndali hovin Ballkanit

Ballkani ka pësuar humbjen e parë në sezonin pranveror pasi është mposhtur të mërkurën nga Malisheva (2-0). Ballkani rrezikon ta humbasë edhe pozitën e parë nëse Gjilani e fiton derbin ndaj Dritës. Fitores i është gëzuar edhe Prishtina, e cila e ka mposhtur Feronikelin 0-3, derisa Ulpiana dhe Dukagjini kanë ndarë pikët duke luajtur baras 1-1



EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 9 MARS - Malisheva, e drejtuar nga Arsim Thaqi, e ka ndalur hovin e skuadrës së Ballkanit, duke ia shkaktuar humbjen e parë në sezonin pranveror. "Të fitohet loja kundër një skuadre siç është Ballkani që në stinorin pranveror i ka fituar të gjitha ndeshjet. Është sukses i dyfishtë. I përgëzoj lojtarët për angazhimin. Këto pikë janë edhe siguri shtesë për ndeshjet e ardhshme. Fitorja ndaj Ballkanit tregon edhe forcën e ekipit. Shpresoj që edhe në ndeshjet e ardhshme lojtarët ta kenë angazhimin e njëjtë. Duhet të vazhdojmë dhe ta ndjekim objektivin që është mbetja në elitën e futbollit të Kosovës", ka thënë trajneri i Malishevës, Arsim Thaqi. Skuadra që synim ka mbijetesën në elitën e

futbollit të Kosovës, Malisheva, të mërkurën e ka mposhtur skuadrën lidere me rezultat 2-0, në ndeshjen e vlefshme për xhiron e 24-t të BKT Superligës së futbollit. Golat i shënuan në fund të pjesës së parë me anë të Mërgim Pefqelit dhe Arbër Pirës. Në pjesën e dytë Ballkani është mundur të rikthehet në lojë, por pa sukses. Kjo ishte humbja e parë e Ilir Dajës prej se është emëruar trajner i skuadrës nga Theranda.

Përgjegjësinë e humbjes së Ballkanit e ka marrë përsipër trajneri Ilir Daja, i cili ka deklaruar: "Besoj se nuk ishte një ditë e mirë për të gjithë. E marr përgjegjësinë për këtë humbje. Bëmë një rotacion për ta freskuar ekipin, por rezultoi negativisht. Sidoqoftë, humbja do të vinte dhe më mirë që erdhi tani për të na ulur me këmbë në tokë pasi nuk ka ndeshje të lehta. Kemi bërë shumë gabime,

sidomos për ndërtimin e aksionit nga mbrojtësit. Gjithsesi, duhet ta harrojmë këtë ndeshje dhe të rikthehemi sa më shpejt te rezultatet pozitive që i patëm gjatë kësaj periudhe". Edhe përkundër kësaj humbje, skuadra e Ballkanit është lidere në elitë, por mund ta humbasë pozitën e parë nëse Gjilani fiton derbin ndaj Dritës. Malisheva renditet në vendin e shtatë me 29 pikë të grumbulluara. Në ndeshjen tjetër Prishtina u është rikthyer fitoreve, duke e mposhtur Feronikelin me rezultat 3-0. Golat për skuadrën kryeqytetase i shënuan Oto John, Besnik Krasniqi dhe Sulley. Pas kësaj ndeshje Prishtina është në vendin e gjashtë me 29 pikë, kurse "Nikli" mbetet e fundit me vetëm 11 pikë. Të mërkurën

është zhvilluar edhe ndeshja në mes të Ulpianës dhe Dukagjinit, e cila ka përfunduar me rezultat 1-1. Skuadra nga Lipjani kaloi e para në epërsi me autogolin e Basriut, kurse Arbër Shala i barazoi shifrat në 1-1. Dukagjini pozicionohet në vendin e tetë me 25 pikë, kurse Ulpiana ka dy pikë më pak.

Sot zhvillohet derbi Drita - Gjilani

Sot (e enjte) zhvillohen dy ndeshje derbi në BKT Superligë. Në Gjilan zhvillohet derbi më i madh i Kosovës. Takohen skuadrat nga ky qytet, Drita dhe Gjilani. Kjo ndeshje ka zgjuar interesim të madh, pasi të dyja këto skuadra janë duke luftuar për titullin e kampionit. Gjilani

BKT SUPERLIGA

Malisheva - Ballkani 2-0
Ulpiana - Dukagjini 1-1
Feronikeli - Prishtina 0-3

Të enjten takohen:
13:00 Drita - Gjilani
13:00 Llapi - Drenica

Tabela

	Pikë
1. Ballkani	48
2. Gjilani	46
3. Drita	41
4. Llapi	39
5. Drenica	31
6. Prishtina	29
7. Malisheva	29
8. Dukagjini	25
9. Ulpiana	23
10. Feronikeli	11

me një fitore eventuale do të kalonte në pozitën e parë, ndërsa nëse Drita e fiton derbin, kampionati do të jetë edhe më interesant për faktin se dallimi në mes të skuadrave kryesuese do të jetë i vogël. Edhe ndeshja tjetër në mes të Llapit dhe Drenicës do të jetë mjaft interesante, pasi të dyja këto skuadra po gëzojnë formë të mirë në sezonin pranveror. Llapi është në pozitën e katërt me 39 pikë, kurse kuqezinjët janë në pozitë më poshtë me 31 pikë.

Ish-futbollisti i Arsenalit kishte paralajmëruar shpërthimin e Brojës

SOUTHAMPTON, 9 MARS - Armando Broja është kthyer në një nga zbulimet e këtij sezoni në futbollin anglez, duke shënuar 12 gola me Southamptonin në të gjithë kompeticionet e duke treguar se mund ta mbajë ritmin e një kampionati të rëndësishëm si Premierë Liga edhe pse në një moshë të re. Pakkush e priste një shpërthim të tillë, por duket se një emër shumë i njohur i futbollit anglez si Jamie Redknapp, ish-lojtar i Liverpoolit e Anglisë, e kishte parashikuar gjithçka shumë vite më parë. Emri i Brojës tani qarkullon vazhdimisht në studiot e emisioneve sportive në Angli dhe duke folur në "Sky Sports News", ish-futbollisti i Arsenalit dhe




Anglisë, Pol Person, zbuloi se në një bisedë me Redknapp disa vjet më parë, kishte dëgjuar për Brojën, kur ai ishte ende pjesë e akademisë së Chelseat. "Jamie Redknapp më tregoi për të tre, katër vjet më parë. Më tha 'është

ky lojtar te Chelsea, një djalë shqiptar, i cili me siguri do të arrijë në majë'", ka treguar ai bisedën që kishte pasur me Redknapp, një nga emrat që ka lavdëruar gjithmonë Brojën për paraqitjet e tij.

KOK-u dërgon në përgatitje sportistët për EYOF 'Vuokatti 2022'

PRISHTINË, 9 MARS - Ekipi olimpiq i Kosovës për Festivalin Olimpik Evropian Dimëror për të Rinj (EYOF) Vuokatti 2022 do të përbëhet nga tre sportistë të skijimit alpin. Kosovën do ta përfaqësojnë Kiana Kryeziu, Arba Pupovci dhe Drin Kokaj, në disiplinat e slallomit dhe slallomit paralel. Për t'u përgatitur sa më mirë për këtë Festival, Komiteti Olimpik i Kosovës ka dërguar në përgatitje të tre skitarët, bashkë me trajnerin e tyre Agim Pupovci. Ekipi po qëndron në Alpet e Austrisë prej 3 marsit deri më 15 mars 2022. "Përgatitjet po shkojnë mirë. Jemi në Alpet e Austrisë, ku kushtet për përgatitje janë shumë



të mira", ka thënë Pupovci për Komitetin Olimpik të Kosovës. EYOF-i dimëror mbahet prej 20-25 mars 2022, në Vuokatti të Finlandës. Festivali ishte paraparë të mbahej vitin e kaluar, por është shtyrë shkaku i pandemisë Covid-19. Për ekipin olimpik të Kosovës do të jetë pjesëmarrja e tretë në EYOF dimëror, pas "Erzurum 2017" dhe "Sarajeva 2019".

Skënderbeu ndërpret bashkëpunimin me trajnerin Memellin

KORÇË, 9 MARS - Skuadra nga Korça, Skënderbeu, me anë të një njoftimi në profilin e saj në rrjetin social "Facebook", ka komunikuar se pas rezultateve të javëve të fundit dhe pas bisedës me drejtuesit, trajneri Migen Memelli ka marrë vendim për t'u larguar nga drejtimi i skuadrës.

Klubi i Skënderbeut e falënderon Memellin për punën dhe përkushtimin që kishte në stolin e ekipit bardhekuq. "Klubi i Futbollit 'Skënderbeu' dhe trajneri Migen Memelli mbyllin bashkëpunimin me marrëveshje. Pas rezultateve të javëve të fundit, pas bisedës me drejtuesit e

klubit, trajneri Migen Memelli ka marrë vendim për t'u larguar nga detyra. Klubi falënderon ish-trajnerin për emocionet, punën dhe përkushtimin e madh në drejtimin e stolit bardhekuq dhe i uron suksese në karrierën e tij. Faleminderit Migen!", thuhet në njoftimin e Skënderbeut.



Shqipëria ngrehet pesë pozita në renditjen e FIBA-s, Kosova dhe Maqedonia bien për nga një pozitë

PRISHTINË, 9 MARS - Renditja e fundit e FIBA-s solli rënie për një pozitë për përfaqësuesen e basketbollit të Maqedonisë. Seniorët e Maqedonisë mbajnë pozitën e 53-të në listën

botërore dhe rënia vjen si rezultat i dy humbjeve në sfidat e muajit shkurt, në kuadër të eliminatoreve për Kupën e Botës 2023. Ndërkohë Përfaqësuesja e Kosovës ka shënuar rënie për një pozitë dhe tani

është në vendin e 72-të, ndërsa Shqipëria ka shënuar ngritje për 5 vende dhe aktualisht është në vendin e 101-të. Nuk ka asnjë befasi në kreun e renditjes, ku Shtetet e Bashkuara të Amerikës

janë shumë përpara Spanjës, Australisë, Francës dhe Sllovenisë. Ndër 100 kombëtarët më të mira në botë, ngritje më të madhe ka bërë Sudani Jugor, i cili shënoi ngritje për 6 vende.



'Dardanët' mbështesin Ademin edhe për një mandat

PRISHTINË, 9 MARS - Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, i shoqëruar nga nënkryetari Bakir Burri, kanë pritur të mërkurën në takim grupin e tifozëve të përfaqësueses, "Dardanët". Me këtë rast, kreu i FFK-së i falënderoi "Dardanët" për kontributin e tyre, për mbështetjen që i kanë dhënë futbollit dhe ekipeve përfaqësuese, për modelin dhe imazhin e mirë që i kanë dhënë vendit, duke veçuar kështu ndeshjen me Anglinë në shtëpi, pritje e cila u vlerësua lart nga FIFA dhe UEFA, por edhe nga vetë federata angleze. "Ademi njoftoi 'Dardanët' me realitetin në futbollin e Kosovës i cili është krejt ndryshe nga ajo që po paraqitet nëpër disa medie vendore. 'Dardanët' e falënderuan presidentin Ademi për punën e mirë, për mbështetjen që ua ofron atyre, pastaj për implementimin e VAR-it në Kosovë dhe për shumë punë të tjera të cilat gjithmonë



janë në të mirë të futbollit", thuhet në njoftimin e FFK-së. Gjithnjë sipas këtij njoftimi, kryetari i "dardanëve", Lulzim Berisha, në emër të tifozëve i ofroi kryetarit Ademi mbështetjen e pakontestueshme edhe për mandatin e ri. Ai, po ashtu, mohoi të kenë keqpërdorur biletat në ndeshjet e Kosovës dhe e siguroi

Ademin se gjithmonë do të jenë në shërbim të vendit, në përkrahje të Kosovës, e në këtë periudhë zgjedhesh në FFK edhe në mbështetje të plotë të kryetarit Agim Ademi, të cilin e vlerësoi si njeriun më të kompletuar dhe më meritor për ta drejtuar futbollin e Kosovës edhe në periudhën e ardhshme katërvjeçare.

Premierë Liga merr vendimin ekstrem, në Rusi nuk do të transmetohet asnjë ndeshje

LONDËR, 9 MARS - Premierë Liga ka pezulluar marrëveshjen e transmetimit të kampionatit anglez me Rusinë pas agresionit ushtarak ndaj Ukrainës fqinje. Ky vendim do të hyjë në fuqi menjëherë, që do të thotë se katër ndeshjet e së enjtes nuk do të transmetohen në vend. Kjo çështje mori vetëm 15 minuta në një takim katërorësh të 20 klubeve elitare në Londër. Gjithashtu, u vendos që Premierë Liga të dhurojë një milionë sterlina për ta mbështetur popullin e Ukrainës. Të drejtat televizive për Premierë Ligë ishin në pronësi të Rambler Group. Kompania ishte në vitin e saj të fundit të një marrëveshjeje trevjeçare për transmetimin e



ndeshjeve në Rusi. Premierë Liga e dënon pushtimin rus të Ukrainës dhe se klubet e saj ranë dakord unanimisht për këtë veprim. Fundjavën e kaluar klubet e Premierë Ligës treguan

solidaritet me Ukrainën pasi kapitenët mbanin shirita të veçantë me ngjyrat e flamurit ukrainas, ndërsa ekranet e stadioneve shfaqnin sloganin "Futbolli na bashkon".

SHKURT

Milani i shtohet garës për Bajramin

Nedim Bajrami është një ndër lojtarët kryesorë të Empolit të këtij sezoni, ku ka rënë në sy me paraqitjet e tij me fanellën e skuadrës toscane dhe tani shumë skuadra janë vënë në ndjekje të tij. Sipas asaj që raporton e përditshmja sportive italiane "TuttoSport", klubet e Serisë A janë të magjepsur pas tij, ku një ndër ta është dhe Milani. Nuk kanë munguar adhuruesit në elitën e futbollit italian, në krye me Juventusin, Fiorentinën, Lazion apo edhe Sassuolo. Aktualisht gjatë këtij sezoni me fanellën e Empolit në Serinë A, Nedim Bajrami është aktivizuar në total në ndeshje nga ku ka realizuar gola dhe ka dhuruar asistime.

Në Ukrainë vritet edhe kampioni 16 vjeç

Sulmet ajrore ruse po vazhdojnë të jenë vdekjeprurëse për popullin ukrainas. Ushtria ruse e goditi të mërkurën në mbremje një ndërtesë me popullsi civile në Sumy. Me këtë rast, viktimë e sulmit agresor ishte edhe mundësi i ri ukrainas i Sambos, Artem Pryimenko. Lajmi është konfirmuar nga kreu i administratës militare rajonale të Sumyt, Dmytro Zhyvytsky. 16-vjeçari ishte në banesën e tij dhe ai bashkë me familjen u vranë nga sulmi ajror rus. Së bashku me të, dy vëllezërit e tij, Igor e Kiril, po ashtu edhe nëna, babai dhe gjyshja e tij, ndërruan jetë. Pryimenko ishte kampion i Ukrainës në SAMBO. Nga ky sulm u vranë 21 njerëz të pafajshëm. Kështu po vazhdon të rritet numri i sportistëve të vranë në Ukrainë. E shumë të tjerë, por edhe ish-sportistë, i janë bashkuar ushtrisë ukrainase në mbrojtje të atdheut.

Pogba mendon rikthimin në United

Mesfushori francez Paul Pogba po e mendon seriozisht rikthimin në Manchester United. Kampioni i botës me Francën kishte vendosur të rikthehej në Manchester United, por ai në "Old Trafford" nuk arriti asnjëherë të jepte më të mirën. Mesfushorit kualitativ do t'i skadojë kontrata gjatë verës që vjen dhe nuk është i interesuar për ta vazhduar përvojën në "Teatrin e Ëndrrave". Në anën tjetër, mediet italiane raportojnë se Pogba do të rikthehet në Juventus. Interesim për 28-vjeçarin kanë shfaqur edhe PSG-ja dhe Real Madridi.

Martinez: Treguam në 'Anfield' se kush është Interi

Në fund të ndeshjes, ku Interi fitoi ndaj Liverpoolit me rezultatin 1-0 me golin e Lautaro Martinez, "Toro" foli për "Sky Sport". "Treguam personalitet dhe dëshirë për ta kaluar raundin. Ne patëm një ndeshje të shkëlqyer edhe në 'San Siro', por pësuam dy gola të pashmangshëm. Në Anfield mbeten me 10 lojtarë dhe prapë u treguam të rrezikshëm, treguam se kush është Interi në mes të 'Anfield', ka thënë Martinez. "Tani jemi jashtë Ligës së Kampionëve, kemi Kupën e Italisë dhe kampionatit përpara. Duhet të bëjmë më të mirën tonë. Sezoni nuk ka mbaruar ende dhe kemi ende trofe për të tentuar. Jemi një ekip me një grup të fortë e të rëndësishëm, por duhet të rritemi në disa detaje", u shpreh Lautaro.

Kloppi, pas kualifikimit: Më vjen mirë që nuk përballemi me Interin çdo javë

Pas humbjes ndaj Interit, por që arritën kualifikimin në fazën e çerekfinale, tekniku i Liverpoolit, Jurgen Klopp, ka folur pas ndeshjes, duke thurur lëvdata për klubin italian. "Më vjen mirë që nuk përballemi me Interin çdo javë. Ai është

kundërshtar shumë i ndërlikuar. Ka luftëtarë", ka thënë fillimisht Klopp. "Vështirësitë që patëm ishin shumë afër asaj që prisja. Interi është një skuadër shumë e mirë, e përgatitur për këto lloj ndeshjesh. Pa luajtur

shkëlqyeshëm, ne patëm shanse të pastra. Ne mund të kishim bërë më mirë kundër një kundërshtari që e bën jetën të pakëndshme. Ishte një lojë vërtet interesante. Në fund ne e humbëm ndeshjen, e cila padyshim

nuk ishte e lezetshme, nuk erdhëm këtu për të humbur një ndeshje në shtëpi. Kundërshtari na shkaktoi probleme, por nëse i kishim shfrytëzuar rastet, fitonim këtë lojë. Humbëm shumë topa të thjeshtë", ka deklaruar Klopp.



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera -
Ministry of Finance, Labour and Transfers
Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosovo - Tax Administration of Kosovo



09.03.2021

Njoftim për tatimpagues**ATK, edhe me një shërbim të ri elektronik!**

Administrata Tatimore e Kosovës, ju njofton se ka publikuar versionin e ri të Sistemit Elektronik – EDI, përmes të cilit tatimpaguesit mund të regjistrohen për tatuarje në bazë të të ardhurave reale.

Shërbimi i ri elektronik për regjistrim të tatimpaguesit për tatuarje në bazë të të ardhurave reale është funksionalizuar në sistemin elektronik EDI dhe është në dispozicion për të gjithë tatimpaguesit, të cilët kanë arritur pragun apo që vullnetarisht zgjedhin për tatuarje në bazë të të ardhurave reale, ashtu siç është e përcaktuar me Ligjin për Tatim në të Ardhura Personale dhe Ligjin për Tatim në të Ardhura të Korporatave.

Tatimpaguesit, që obligohen apo vullnetarisht zgjedhin të regjistrohen për tatuarje në bazë të të ardhurave reale, kërkesën për regjistrim, do ta parashtrajnë përmes Sistemit Elektronik EDI.

Për t'u regjistruar për tatuarje në bazë të të ardhurave reale, tatimpaguesi duhet të ndjek hapat si në vijim:

1. Kyçet në sistemin EDI;
2. Klikon në menynë "Shërbimet";
3. Zgjedh nën menynë "Formularët elektronik";
4. Zgjedh llojin e formularit "Kërkesë për tatuarje në të ardhura reale"; dhe
5. Plotëson kërkesën dhe klikon mbi butonin "Regjistrohu".

Pasi të parashtrohet kërkesa nga ana e tatimpaguesit, sistemi do të bëjë verifikimin e të dhënave të tatimpaguesit. Vetëm për tatimpaguesin që plotëson të gjitha kriteret për tatuarje në bazë të të ardhurave reale, regjistrimi do të bëhet në mënyrë elektronike.

Në momentin e regjistrimit të tatimpaguesit për tatuarje në bazë të të ardhurave reale, tatimpaguesi pranon mesazhin, me të cilin njoftohet se regjistrimi ka përfunduar me sukses dhe njëherësh në mënyrë automatike i hapen llogaritë tatimore përkatëse, gjegjësisht llogaritë: IL dhe PD për Personin fizik afarist apo QL dhe CD për Personin Juridik.

ATK mban premtimin për kujdesin e vazhdueshëm ndaj tatimpaguesve!

Administrata Tatimore e Kosovës



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government
Ministria e Drejtësisë-Ministraskvo Pravde-Ministry of Justice



Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar / Agjencia za Upravljanje Zoplenjenom i Konfiskovanom Imovinom/Agency for Administration of Sequestrated and Confiscated Assets

Ftesë për Ankand Publik

Datë 09.03.2022 Referenca: AAPSK-003/2022

AAPSK- njofton të gjithë të interesuarit se ofron për shitje mallin si në vijim, sipas lëndës së paraqitura më poshtë:

Nr	Përshkrimi	Sasia/copë	Çmimi Fillestar/copë	Çmimi nga ofertuesi	Çmimi total €
1	VW Golf 4 viti i prodhimit 1998,benzin, ngjyre e kaltër metalike, me targa vendore	1 copë	1,400.00€		
2	Seat 6 L- Ibiza viti i prodhimit 2007,dizel, ngjyre e zeze, me targa vendore	1 copë	3.375.00€		
3	Mercedes S 320 viti i prodhimit 1999,benzin, ngjyre e zeze metalike, automatik- me targa vendore	1 copë	900.00€		
4	Furgon Mercedes-Benz MB 100, viti i prodhimit 1991,dizel, ngjyre e kuqe, me targa vendore	1 copë	500.00€		
5	Furgon VW LT 35 viti i prodhimit 2000,dizel, ngjyre e bardhe me targa vendore	1 copë	3,000.00€		
6	VW Golf II, viti i prodhimit 1985,benzin, ngjyre e kaltër - për skrap	1 copë për skrap	222.00€		
7	Opel Vectra, viti i prodhimit 1990,benzin, ngjyre e kuqe metalike - për skrap	1 copë për skrap	280.00€		
8	VW Golf II, viti i prodhimit 1987,Dizel, ngjyre e zeze - për skrap	1 copë për skrap	232.00€		
9	Mercedes Benz 200 viti i prodhimit 1991,dizel, ngjyre e hirit metalike- për pjesë	1 copë/ për pjesë	350.00€		
10	VW Golf II, viti i prodhimit 1984,benzin, ngjyre e bardhë - për skrap-Rishpallje	1 copë për skrap	145.76€		
11	VW Passat 35 L, viti i prodhimit 1990,dizel, ngjyre e zeze - për skrap-Rishpallje	1 copë për skrap	262.50€		
12	Furgon Fiat Tranzit (Ducato) ,viti i prodhimit 1999,dizel, ngjyre e bardhe - për pjesë-Rishpallje	1 copë/ për pjesë	292.50€		
13	VW Golf II viti i prodhimit 1985, ngjyre e hirit, benzin - për pjesë-Rishpallje	1 copë/ për pjesë	150.00€		

Oferta e nënshkruar, vulosur dhe e mbyllur në zarf duhet të dorëzohet më së largu deri më 16.03.2022 në ora 11:00h, në lokalet e AAPSK-së, në adresën: Depo e Agjencisë Rr. Bajram Bahtiri (ish Kazerma e FSK-se) fshati Llukar KK Prishtinë. Të interesuarit mallin mund ta shikojnë me datë: 16.03.2022, prej orës 10:00-11:00 në Depon e Agjencisë në fshatin Llukar KK Prishtinë.

Pasurit e sekuestruar ose të konfiskuara në këtë procedurë shitje procedohen për shitje, me çmimin e lartë cekur në gjendjen siç janë. Të drejtë pjesëmarrjeje kanë të gjithë personat fizik dhe juridik. Personat juridik të cilët marrin pjesë duhet që me veti të sjellin Certifikatën e regjistrimit të biznesit, kurse personat fizik kopjen e letërnjoftimit personal. Fitues do të jetë oferta e ofruar me çmimin më të lartë. Të interesuarit mund të tërheqin dokumentacionin e ankandit-listën e artikujve në zyrën nr 1012, prej orës 08:00-16:00, ose mund të shkarkohen në web faqen e AAPSK-se në: <https://md.rks.gov.net>. Në zarf të shkruhet për: AAPSK, Sektori i Shitjes; oferta mos të hapet para orës 11:00.

Adresa: Ministria e Drejtësisë, Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar Ish Pallati i Rilindjes, kati 10, Divizioni i Shitjes nr. 1012, Prishtinë, tel 038 200 18 051.
PËR SIGURINË E JUAJ DHE PUNONJËSVE TANË, JU LUSIM QË GJATË PJESËMARRJES NË ANKAND TË MBANI MASKËN KUNDËR COVID19; MBANI DISTANCËN DHE DEZINFEKTONI DUART RREGULLISHT!

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "Ordinanca Specialistike Anthropotomy" SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811466160 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Ordinanca Specialistike Anthropotomy" D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811466160 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "Ordinanca Specialistike Anthropotomy" L.L.C. has come to the decision to quit its business: 811466160 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Arbër Dakaj shpall të pavlefshme diplomën e Fakultetit Ekonomik Prishtinë, me nr. të dosjes:136889.

► Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalit më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A Paraguay, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales

